LIGJ
Nr.7561, datë 29.4.1992

PËR DISA NDRYSHIME E PLOTËSIME NË LIGJIN NR.7491, DATË 29.4.1991 "PËR DISPOZITAT KRYESORE KUSHTETUESE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" të Kuvendit Popullor, pas kreut III të shtohet një kre më vete, si dhe të bëhen disa ndryshime e plotësime si vijon:

ORGANIZIMI I DREJTËSISË DHE GJYKATA KUSHTETUESE

I. SISTEMI GJYQËSOR

Neni 1

Pushteti gjyqësor është i ndarë dhe i pavarur nga pushtetet e tjera. Ai ushtrohet vetëm nga organet e njohura nga ligji "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Neni 2

Gjykata është autoriteti që zgjidh çështjet dhe mosmarrëveshjet që lidhen me zbatimin e ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të ligjeve nëpërmjet caktimit të dënimeve penale, të dëmshpërblimeve civile, të njohjes të të drejtave dhe detyrimeve të palëve, si edhe urdhërimit të masave për mbrojtjen dhe vendosjen e tyre, pas një procesi të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Neni 3

Drejtësia jepet në emër të popullit.
Rastet dhe mënyra e pjesëmarrjes së popullit në dhënien e drejtësisë përcaktohen me ligj.

Neni 4

Drejtësia u përmbahet parimeve të ligjshmërisë dhe të barazisë së personave para ligjit mbi bazën e respektimit të së drejtës.

Neni 5

Sistemi gjyqësor përbëhet nga Gjykata e Kasacionit, gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë dhe nga gjykatat ushtarake.
Ndalohet krijimi i gjykatave të jashtëzakonshme.
Organizimi dhe kompetencat e gjykatave rregullohen me ligj.

Neni 6

Gjykata e Kasacionit është autoriteti më i lartë gjyqësor. Mund të jenë anëtarë të saj vetëm shtetasit shqiptarë të diplomuar në drejtësi, të dalluar për aftësitë e tyre profesionale dhe që kanë vjetërsi në organet e drejtësisë ose si pedagogë në Fakultetin e Drejtësisë, jo më pak se 7 vjet.

Kryetari dhe zëvendëskryetarët e Gjykatës së Kasacionit zgjidhen nga Kuvendi Popullor me propozim të Presidentit të Republikës. Gjyqtarët e saj zgjidhen nga Kuvendi Popullor.

Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Kasacionit zgjidhen në detyrë një herë në 7 vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Ata nuk mund të ndalohen, të arrestohen ose të dënohen për veprimet që lidhen me përmbushjen e detyrave të tyre.

Gjyqtari i Gjykatës së Kasacionit mund të lëvizet nga detyra vetëm mbi bazën e një vendimi të arsyetuar të Kuvendit Popullor kur vërtetohet se ka kryer një nga veprat e rënda penale të parashikuara posaçërisht me ligj ose kur është i paaftë mendërisht.

Neni 7

Gjykata e Kasacionit nuk mund të shqyrtojë asnjë çështje në shkallë të parë, kurse në shkallë të dytë gjykon vetëm çështjet e parashikuara me ligj. Ajo shqyrton vetëm bazën ligjore të vendimeve gjyqësore që i paraqiten në rrugë kundërshtimi ose që i tërheq vetë.

Neni 8

Në ushtrimin e kompetencave të tyre gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe ligjeve.

Kur gjatë shqyrtimit të çështjes, gjykata arrin në përfundimin se akti normativ nuk pajtohet me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe me ligjet, ajo pezullon gjykimin dhe ia dërgon materialet e çështjes Gjykatës Kushtetuese.

Neni 9

Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Ato mund të anulohen, të prishen ose të ndryshohen vetëm me vendim të një gjykate më të lartë, në kushtet e parashikuara me ligj.

Të gjitha organet shtetërore dhe autoritetet e tjera publike janë të detyruara të sigurojnë zbatimin e vendimeve dhe të akteve gjyqësore.

Neni 10

Gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit kanë immunitet dhe nuk mund të lëvizen nga detyra gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Heqja e imunitetit, si dhe lëvizja e tyre mund të bëhet vetëm nga organi kompetent, në rastet dhe sipas procedurës së caktuar me ligj. Asnjë ligj nuk mund të kufizojë garancitë e gjyqtarëve të parashikuara nga ky ligj kushtetues dhe nga rregullat ndërkombëtare.

Neni 11

Gjyqtarët janë të detyruar të mos marrin pjesë në zgjidhjen e çështjeve, kur ka shkaqe ligjore që kompromentojnë paanësinë e tyre, si dhe të mënjanojnë çdo sjellje, që vë në dyshim real drejtësinë ose ul dinjitetin e saj.

Neni 12

Gjykimi i çështjeve bëhet gojarisht në mënyrë publike. Ligji mund të ndalojë praninë në gjykim të publikut ose të mjeteve të informimit vetëm në rrethana të veçanta, kur kjo është krejtësisht e domosdoshme për nevojat e sigurimit kombëtar, të rendit publik ose për mbrojtjen e interesave të të miturve, të palëve private dhe të drejtësisë.

Procedura në orgnet e drejtësisë zhvillohet në gjuhën shqipe. I pandehuri, palët, dëshmitari dhe pjesëmarrësit e tjerë në procesin gjyqësor, që nuk e dinë ose nuk kuptojnë gjuhën shqipe, kanë të drejtë të flasin me ndihmën e një përkthyesi.

Neni 13

Prokuroria është autoriteti që ushtron ndjekjen penale në hetim dhe në gjyq.

Në veprimtarinë gjyqësore prokuroria mbron interesat e përgjithshme të shoqërisë, të rendit juridik, si dhe të drejtat dhe liritë e shtetasve.

Prokuroria organizohet dhe funksionon brenda pushtetit gjyqësor si organ unik dhe i centralizuar.

Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët i nënshtrohen ligjit, urdhërave të prokurorëve eprorë dhe vendimeve të autoriteteve gjyqësore përkatëse.

Prokurorët kanë imunitet.

Neni 14

Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësimi i tij zgjidhen nga Kuvendi Popullor, me propozim të Presidentit të Republikës. Ata gëzojnë imunitetin dhe të drejtat e parashikuara nga neni 6 i këtij ligji kushtetues për gjyqtarët e Gjykatës së Kasacionit.

Organizimi dhe kompetencat e tjera të prokurorisë rregullohen ne ligj.

Neni 15

Këshilli i Lartë i Drejtësisë kryesohet nga Presidenti i Republikës dhe përbëhet nga Kryetari i Gjykatës së kasacionit, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe nga 9 juristë të njohur për aftësitë e tyre, që zgjidhen një herë në pesë vjet në mbledhjen e përbashkët të Gjykatës së Kasacionit dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është i vetmi autoritet që vendos për emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të shkallës së parë, të apelit, si dhe të prokurorëve.

Mënyra e funksionimit dhe e ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë përcaktohet me rregulloren e miratuar prej tij.

Neni 16

Avokatia ushtrohet si profesion i lirë. Veprimtaria e avokatisë rregullohet me ligj të veçantë.

Detyra e avokatëve është t'u japin klientëve ndihmën dhe këshilla të nevojshme juridike sipas ligjit dhe normave të etikës profesionale.

II. GJYKATA KUSHTETUESE

Neni 17

Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë, që mbron dhe garanton respektimin e Kushtetutës dhe të legjislacionit, si dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Në ushtrimin e funksioneve të saj, ajo është e pavarur dhe i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.

Neni 18

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, 5 nga të cilët zgjidhen nga Kuvendi Popullor dhe 4 nga Presidenti i Republikës.

Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjedhin me votim të fshehtë kryetarin e saj, i cili qëndron në këtë detyrë për tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Afati i 3 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të caktuar në zgjedhjen e parë mbaron në krye të 3 vjetëve. Emrat e tyre caktohen me short, në secilin grup gjyqtarësh të zgjedhur nga Kuvendi Popullor dhe nga Presidenti i Republikës. Pas 3 vjetëve të tjerë, zëvendësohen në të njëjtën mënyrë, me short nga 3 gjyqtarë të tjerë. Gjyqtarët zëvendësues qëndrojnë në detyrë 12 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 19

Gjyqtarët kushtetues, para se të fillojnë ushtrimin e funksioneve të tyre, bëjnë betimin para Presidentit të Republikës.

(Formula e betimit është: “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrave të mia do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë”).

Neni 20

Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese zgjidhen juristë të njohur për aftësitë e tyre, që kanë punuar për jo më pak se 10 vjet në veprimtarinë juridike ose si pedagogë në Fakultetin e Drejtësisë dhe që kanë reputacion të lartë moral.

Neni 21

Gjyqtari kushtetus nuk mund të jetë deputet, anëtar i Këshillit të Ministrave, gjyqtar, hetues ose prokuror, anëtar i një partie a organizate tjetër politike ose sindikate, si dhe nuk mund të kryejë veprimtari të tjera publike e private, që mund të cenojnë pavarësinë ose paanësinë e tij.

Neni 22

Gjyqtari kushtetues nuk ka përgjegjësi për vendimet dhe për mendimet e dhëna në ushtrim të funksioneve të tij. Ai nuk mund të procedohet, të ndalohet, të arrestohet ose të dënohet pa autorizimin e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 23

Funksioni i gjyqtarit kushtetues mbaron kur:

a) nuk e ushtron pa shkaqe të përligjura detyrën për më shumë se gjashtë muaj;

b) jep dorëheqje;

c) kur caktohet në detyrë që nuk pajtohen me funksionin e tij;

ç) kalon afati, për të cilin është zgjidhur. Gjyqtari në këtë rast vazhdon t’i kryejë funksionet edhe tej afatit, vetëm kur një çështje e filluar nuk mund të përfundojë brenda kësaj kohe.

Kur, për ndonjë nga shkaqet e mësipërme, funksioni i gjyqtarit kushtetues mbaron para përfundimit të mandatit për të cilin është zgjedhur, Kuvendi Popullor ose Presidenti i Republikës sipas përkatësisë, zgjedh një gjyqtar të ri, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë deri në ditën kur do të përfundonte mandati i gjyqtarit të larguar.

Neni 24

Gjykata Kushtetuese ka këto kompetenca:

1. Bën interpretimin e Kushtetues dhe të ligjeve kushtetuese.

2. Gjykon papajtueshmërinë e ligjeve dhe të akteve që kanë fuqinë e ligjit me Kushtetutën;

3. Gjykon papajtueshmërinë e akteve dhe dispozitave nënligjore me Kushtetutën dhe me ligjin.

4. Vendos për pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare, që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë, para ratifikimit të tyre, si dhe për përputhjen e ligjeve me normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, si dhe me marrëveshjet në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

5. Zgjidh mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ato ndërmjet autoriteteve lokale dhe pushtetit qendror.

6. Vendos për çështjet që lidhen me kushtetueshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike e shoqërore dhe mund të ndalojë veprimtarinë e tyre.

7. Zgjidh çështjet për ligjshmërinë e zgjedhjes së Presidentit të Republikës, të deputetëve, si dhe të referendumit popullor, duke shpallur rezultatet përfundimtare.

8. Shqyrton akuzën penale të ngritur kundër Presidentit të Republikës.

9. Zgjidh përfundimisht ankesat e personave të paraqitura në rrugën e kontrollit kushtetues për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme.

10. Vendos pezullimin e zbatimit të ligjit kur vëren se nuk pajtohet me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe pezullimin ose shfuqizimin e akteve e të dispozitave të tjera, kur vëren se nuk pajtohen me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" ose me ligjin, si dhe merr masat që çmon të përshtatshme për çështjen që gjykon.

Kur gjykata vë re se është shkelur një e drejtë e mbrojtur nga ligji kushtetues, ajo vendos njohjen dhe garantimin e saj, dhe, kur është rasti, ndreqjen e pasojave dhe kompensimin e duhur të dëmit të shkaktuar.

Gjykata Kushtetuese, gjithashtu, mund të vendosë që çdo organ shtetëror, çdo organizatë shoqërore a person juridik të anulojë, shfuqizojë a ndryshojë vendimin individual me të cilin është cenuar e drejta kushtetuese e personit.

Neni 25

Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë ose edhe me nismën e saj.

Për fillimin e procedurës kanë të drejtë të bëjnë kërkesë Presidenti i Republikës, një grup parlamentar, një e pesta e deputetëve, Këshilli i Ministrave, gjykatat, organet lokale të pushtetit, si dhe çdo person, lidhur me shkeljen e lirive dhe të drejtave të tij të parashikuara nga Kushtetuta.

Neni 26

Gjykata Kushtetuese vendos me shumicë votash. Gjyqtari në pakicë ka të drejtë t'i bashkëlidhë vendimit mendimin e tij të veçantë të formuluar me shkrim.

Vendimet e gjykatës janë përfundimtare dhe të formës së prerë. Ato duhet të jenë të arsyetuara. Në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e vendimit, gjykata ka të drejtë ta interpretojë atë, kryesisht ose me kërkesën e të interesuarve brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të kërkesës.

Ligji, akti që ka fuqinë e ligjit, akti nënligjor dhe dispozitat e veçanta të tyre që shpallen të papajtueshme me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe me ligjin, me normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare a të marrëveshjeve, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, e humbasin fuqinë të nesërmen e shpalljes së vendimit në "Gazetën Zyrtare".

Në rastet e tjera vendimi i Gjykatës Kushtetuese hyn në fuqi në afatin e parashikuar prej tij.

Kur vendoset anullimi, shfuqizimi a ndryshimi i ligjeve ose i akteve të tjera dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i njoftohet Kuvendit Popullor ose organeve të tjera kompetente që të marrin masat e parashikuara nga Kushtetuta.

Neni 27

Aktet e Gjykatës Kushtetuese shprehin kushtetueshmërinë dhe ligjshmërinë e çështjeve që ajo zgjidh.

Neni 28

Organizimi dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese, procedura e zgjidhjes së çështjeve, si dhe çështjet e tjera themelore për kryerjen e detyrave, rregullohen me ligj.

III. DISPOZITA KALIMTARE

Neni 29

Administrata gjyqësore varet nga Ministri i Drejtësisë.

Pushteti gjyqësor ka buxhetin e vet, që me propozim të Këshillit të Ministrave miratohet nga Kuvendi Popullor dhe caktohet në masën që e mundëson të funksionojë normalisht.

Neni 30

Paga e gjyqtarëve dhe e prokurorëve caktohet me ligj.

Neni 31

Në nenin 16 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” bëhen këto ndryshime:
Pika 2 ndryshohet si vijon: “Miraton dhe ndryshon Kushtetutën dhe ligjet”.
Pika 9 shfuqizohet.

Neni 32

Në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese” paragrafi i parë i nenit 42 ndryshohet: “Organet e pushtetit lokal administrohen lirisht dhe zgjidhen sipas rregullave të caktuara me ligj të veçantë”.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.171, datë 30.4.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha